



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 3116 Prot

Vlorë, më 13.02 2026

Lënda : Mbi miratimin e planit të pranimi/rekrutimit në shërbimin civil për vitin 2026.

Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neni 18, "Plani vjetor i pranimi në shërbimin civil", Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 108, datë 26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil" dhe VKB-në nr. 98, datë 27.11.2025 "Për miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të deleguara - 2026" miratohet plani i pranimi/rekrutimit në shërbimin civil për vitin 2026 si më poshtë:

Bazuar në gjermën a) "*Mbushjen e moshës së pensionit të nëpunësit civil*" të pikës 3, të VKM nr. 108, datë 26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil", në stafin e Bashkisë Vlorë, për vitin kalendarik Janar-Dhjetor 2026, janë **2 punonjës** të cilët kanë mbushur moshën e pensionit **(2 pozicione)**.

Bazuar në gjermën b) "*Parashikimin e vendeve të reja në shërbimin civil*", të pikës 3, të VKM nr. 108, datë 26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil", pozicionet vakante të planifikuara për vitin kalendarik Janar-Dhjetor 2026, janë **28 pozicione**.

Gjithsej vende vakante në shërbimin civil për periudhën Janar - Dhjetor 2026 në Bashkinë Vlorë janë **30 pozicione**.

**PLANI VJETOR I PRANIMEVE NË SHËRBIMIN CIVIL TË BASHKISË VLORE PËR
VITIN 2026**

Vende të lira në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil	Kategoria	Numri i Vendeve Vakante	Klasa	Lloji i procedurës
Drejtor drejtorie	Nivel i mesëm drejtues	9	II-2	Lëvizje paralele/Ngritje në detyrë
Përgjegjës sektori	Nivel i ulët drejtues	3	III-2 III-3	Lëvizje paralele/Ngritje në detyrë
Specialist	Nivel ekzekutiv	16	IV-2	Lëvizje paralele/Pranim në shërbim civil

KRYETAR

Brunilda Mersini

